

**VENDIM**  
**Nr.12, datë 4.1.2012**

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E  
BRENDSHME TE MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, TË  
OBJEKTEVE “POSTA E POLICISË KUFITARE, VIVAR”, SARANDË DHE “POSTA E  
POLICISË KUFITARE, KSAMIL” DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.250, DATË  
24.4.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT  
TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË  
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 10, 11, 12, 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit nga Ministria e Brendshme te Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, të objekteve “Posta e Policisë Kufitare, Vivar”, Sarandë, dhe “Posta e Policisë Kufitare, Ksamil”, sipas formularëve bashkëlidhur, për t’u përdorur për interesa publikë.
  2. Pronat e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, hiqen nga lista e inventarit ta pronave shtetërore që i bashkëlidhet vendimit nr.250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave.
  3. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronave, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, t’i tjetërsojë ose t’i japë në përdorim të tretëve.
  4. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**